



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Adresa Rr. Zija Shemsiu pn, 60000 Gjilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net

Rektori: Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

Vendim.nr. 011171/21/09/2020

Në bazë të nenit 48, pika 1.3 të Statutit të përkohshëm të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, Senati i Universitetit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 10.09.2020, mori:

VENDIM

PhD.cand. Nexhat Shkodra, rizgjedhet në thirrjen akademike **Asistent** për lëndët: Mikroekonomi dhe Makroekonomi në Fakultetin Ekonomik në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan.

Emërimi është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 153 dhe 159 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan dhe Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

I përmenduri është i obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statuti të Përkohshëm të Universitetit.

Emërimi zgjatë 3/tre/vite.

Të përmendurit i takon paga në pajtim me Rregulloren për të ardhurat personale.

Kontrata e punës do të lidhet në pajtim me dispozitat pozitive.

Arsyetim

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan ka shpallur konkurs për zgjedhjen/rizgjedhjen e një asistenti lëndët: Mikroekonomi dhe Makroekonomi në Fakultetin Ekonomik në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan.

Komisioni recensues dhe Komisioni i studimeve i ka propozuar Senatit të Universitetit që Ass. Nexhat Shkodra, i plotëson kushtet për t'u rizgjedhur në thirrjen akademike Asistent për lëndët e sipërpërmendura.


Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, duke i marrë për bazë vlerësimin e Komisionit Recensues dhe propozimin e Komisionit të Studimeve, vendosi që Ass. Nexhat Shkodra, të rizgjedhet në thirrjen akademike Asistent.

Në bazë të kësaj që u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në web faqe të Universitetit drejtuar Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa të Senatit të Universitetit.

REKTORI

Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi



Vendimi t'i dërgohet:

1. Të përmendurit
2. Zyrës së personelit
3. Arkivit të Universitetit
4. Zyrës së financave